

VENDIM I ORTAKËVE
TË
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BLUE TDI SH.P.K.

BLUE TDI Sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me NUIS L91926023K dhe me seli në adresën: Rruga "Themistokli Gërmenji", Nr. 6, Kati i I, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë, (këtu e më poshtë referuar si "Shoqëria").

Vendi i Mbledhjes: Tiranë, Shqipëri

Data e Mbledhjes: 15.11.2021

Nr i vendimit: 1

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë, si më poshtë:

- Ortaku, Shoqëria **Matrix Konstruksion Sh.p.k.** zotërues i 32.50 % (tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitali. Shoqëria përfaqësohet në mbledhje nga Znj.Ida MEZINI.
- Ortaku, Shoqëria **GBI Sh.p.k.** zotërues i 22.50% (njëzet e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitali. Në këtë mbledhje përfaqësohet nga Z. Hajredin DIBRA.
- Ortaku, Shoqëria **WSI Sh.p.k.** zotërues i 45% (dyzet e pesë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitali. Në këtë mbledhje përfaqësohet nga Z.Bledar SINANI.

Rendi i ditës:

- Vendim mbi fillimin e procedurës për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- Caktimi i Audituesit Ligjor për përgatitjen e raportit mbi zmadhimin e kapitalit të regjistruar.
- Të Ndryshme.

MEQËNËSE:

- A. BLUE TDI Sh.p.k.**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me kapital të zotëruar nga ortakët e shoqërisë.
- B.** Në përputhje me Nenin 6, paragrafi (6.1), të Statutit të Shoqërisë, Ortaket e Shoqërisë dëshirojnë të fillojë procedurat për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, nga vlera aktuale prej 225,859,743 (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre) lekë në **251,210,298 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.**
- C.** Në përputhje me Nenin 9, paragrafi (9.2), pika b, të Statutit të Shoqërisë, Ortaket e Shoqërisë dëshirojnë të caktojë shoqërinë I.L.D.-99 Audit sh.p.k me nipt K31516110I me seli në adresën Rr. Emin Duraku, Pall. Aviacioni i Vjetër, Shk. 6, Ap. 66, Tiranë, Shqipëri, të

përfaqësuar nga administratori Z. Luan Kamberi, lindur më 23.02.1965, në Tepelenë, Shqipëri, banues në Rr. "Komuna e Parisit", Tiranë, Shqipëri, mbajtës i licensës së Audituesit Ligjor Nr. 40, datë 10.02.2000, në cilësinë e Audituesit Ligjor me detyrën përgatitjen e raportit për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.

- D. Janë plotësuar të gjitha kushtet për mbajtjen e Mbledhjes së Asamblesë, e cila është thirrur dhe organizohet në përputhje me Statutin dhe Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**").

Pas diskutimit të çështjeve Asambleja e Ortakëve miraton me unanimitet të plotë vendimet e mëposhtme:

PËR SA MË SIPËR, Ortakët e Shoqërisë, VENDOSËN:

- I. **Të fillojnë** procedurat për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- II. **Të caktojnë** shoqërinë I.L.D.-99 Audit sh.p.k me nipt K31516110I me seli në adresën Rr. Emin Duraku, Pall. Aviacioni i Vjetër, Shk. 6, Ap. 66, Tiranë, Shqipëri, të përfaqësuar nga administratori Z. Luan Kamberi, lindur më 23.02.1965, në Tepelenë, Shqipëri, banues në Rr. "Komuna e Parisit", Tiranë, Shqipëri, mbajtës i licensës së audituesit ligjor me Nr. 40, datë 10.02.2000, në cilësinë e audituesit ligjor për përgatitjen e raportit lidhur me zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.
- III. **Të miratojnë** në parim zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë nga vlera aktuale prej 225,859,743 (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre) lekë në **251,210,298 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.**
- IV. **Të autorizojnë** Administratorin e Shoqërisë, Zj. Ana Lleshi në lidhje me nënshkrimin dhe dorëzimin për llogari të Shoqërisë të çdo dokumenti të nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi dhe në përgjithësi të kryejë të gjithë veprimet e duhura për kompletimin e tij dhe të ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë për depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, deri në marrjen e ekstraktit përkatës që vërteton kryerjen e këtyre veprimeve për të cilat autorizohet.

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, përbërë nga Ortakët e Shoqërisë, që u mbajt sot më 15.11.2021 dhe që u mbyll në orën 12:00, nuk u mor asnjë vendim tjetër.



ORTAKËT E SHOQËRISË

WSI Sh.p.k.

Bledar Sinani

Bledar SINANI
SIG Holding GmbH
Ferdinand-Markl-Str.22
4040 Linz, Austria
office.siggmbh@yahoo.com
ATU 65456222

Matrix Konstruktion Sh.p.k.

Ida Mezini

Ida MEZINI

GBI Sh.p.k.

Hajredin Dibra

Hajredin DIBRA

GBI SH.P.K.

NIPT : L 62205042 E



**VENDIM I ORTAKËVE
TË
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BLUE TDI SH.P.K.**

BLUE TDI Sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me NUIS L91926023K dhe me seli në adresën: Rruga "Themistokli Gërmenji", Nr. 6, Kati i I, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë, (këtu e më poshtë referuar si "**Shoqëria**").

Vendi i Mbledhjes: Tiranë, Shqipëri
Data e Mbledhjes: 02.12.2021
Nr i vendimit: 2

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë, si më poshtë:

- Ortaku, Shoqëria **Matrix Konstruksion Sh.p.k.** zotërues i 32.50 % (tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitali. Shoqëria përfaqësohet në mbledhje nga Znj.Ida MEZINI.
- Ortaku, Shoqëria **GBI Sh.p.k.** zotërues i 22.50% (njëzet e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitali. Në këtë mbledhje përfaqësohet nga Z. Hajredin DIBRA.
- Ortaku, Shoqëria **WSI Sh.p.k.** zotërues i 45% (dyzet e pesë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitali. Në këtë mbledhje përfaqësohet nga Z.Bledar SINANI.

Rendi i ditës:

- Miratimi i raportit të audituesit ligjor lidhur me zmadhimin e kapitalit të regjistruar.
- Miratimi i zmadhimit të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- Ndryshimi i Statutit të Shoqërisë.
- Të Ndryshme.

MEQËNËSE:

- A. **BLUE TDI Sh.p.k.**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me kapital të zotëruar nga ortakët e shoqërisë.
- B. Në përputhje me Nenin 6, paragrafi 6.1, të Statutit të Shoqërisë, kanë filluar procedurat për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë, nga vlera aktuale prej 225,859,743 (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre) lekë në 251,210,298 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.

- C. Sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë datë 15.11.2021, shoqëria I.L.D.-99 Audit sh.p.k me nipt K31516110I me seli në adresën Rr. "Emin Duraku", Pall. Aviacioni i Vjetër, Shk. 6, Ap. 66, Tiranë, Shqipëri, përfaqesuar nga administratori Z. Luan Kamberi, lindur më 23.02.1965, në Tepelenë, Shqipëri, banues në Rr. "Komuna e Parisit", Tiranë, Shqipëri, mbajtës i licensës së Audituesit Ligjor Nr. 40, datë 10.02.2000 është caktuar me detyrën e përgatitjes së raportit mbi zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë nga vlera aktuale prej 225,859,743 (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre) lekë në **251,210,298** (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.
- D. Në përputhje me Nenin 9, paragrafi 9.2, pika c të Statutit, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë merr vendimin për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.
- E. Janë plotësuar të gjitha kushtet për mbajtjen e Mbledhjes së Asamblesë, e cila është thirrur dhe organizohet në përputhje me Statutin dhe Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**").

PËR SA MË SIPËR, Ortakët e Shoqërisë, VENDOSËN:

I. Miratimin e Raportit – Të miratojnë Raportin për zmadhimin e kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë të hartuar nga audituesi ligjor I.L.D.-99 Audit sh.p.k.

- II. **Miratimin e zmadhimit të kapitalit të regjistruar** - Të miratojnë zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë nga vlera aktuale prej 225,859,743 (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre) lekë në **251,210,298 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.**
- Të miratojnë rregullisht ndryshimin e Statutit të Shoqërisë, në pjesën e kapitalit themeltar i cili riformulohet si më poshtë: Kapitali themeltar i shoqërisë nga 225,859,743 (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre) lekë rritet edhe me 25,350,555 (njëzetë e pesë million e treqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë dhe bëhet 251,210,298 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.
 - Kapitali është i ndarë në 3 kuota.
 - Ortakët zotërojnë pjesë të kapitalit të Shoqërisë si në vijim:
 - Ortaku, Shoqëria **Matrix Konstruksion Sh.p.k.** zotëron 1 kuotë, e barabartë me 32.50 % (tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë 81,643,346.50 (tetëdhjetë e një million e gjashtëqind e dyzetë e tre mijë e treqind e dyzetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) lekë.
 - Ortaku, Shoqëria **GBI Sh.p.k.** zotëron 1 kuotë, e barabartë me 22.50% (njëzet e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë 56,522,317.50 (pesëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e njëzetë e dy mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë) lekë.

-Ortaku, Shoqëria **WSI Sh.p.k.** zotëron 1 kuotë, e barabartë me 45% (dyzet e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë 113,044,634 (njëqind e trembëdhjetë million e dyzetë e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) lekë.

- III. **Të autorizojnë** Administratorin e Shoqërisë, Znj. Ana Lleshi në lidhje me nënshkrimin dhe dorëzimin për llogari të Shoqërisë të çdo dokumenti të nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi dhe në përgjithësi të kryejë të gjithë veprimet e duhura për kompletimin e tij dhe të ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë për depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, deri në marrjen e ekstraktit përkatës që vërteton kryerjen e këtyre veprimeve për të cilat autorizohet.

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, përbërë nga Ortakët e Shoqërisë, që u mbajt sot më 02.12.2021 dhe që u mbyll në orën 13:00, nuk u mor asnjë vendim tjetër.

ORTAKËT E SHOQËRISË

WSI Shpk.

Bledar Sinani

Bledar SINANI

SIG Holding GmbH

Ferdinand-Markl-Str.22

4040 Linz, Austria

office.siggmbh@yahoo.com

ATU 65456222

Matrix Konstruksion Shpk.

Ida Mezin

Ida MEZINI

GBI Shpk.

Hajredin Dibra

Hajredin DIBRA

GBI SH.P.K.

NIPT : L 62205042 E

